



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

Nr. _____ Prot.

Date ____/____/2021

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 27/01/2021

Për: OE A. N. K. Shpk, me adrese “Rruga e Kavajes”, Pallatet “Condor”, Kulla 1, Hyrja e pare, kati i trete, Tirane.

Procedura e prokurimit: E Hapur/ Pune

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-82190-12-15-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Ndertimi i ujesjellesit per zonat bregdetare te Njesise Administrative Shenkoll, Bashkia Lezhe.

Kohëzgjatja e kontratës: **48 Muaj** nga data e nenshkrimit te kontrates.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

- Operatori Ekonomik “A.N.K.” Shpk, me Nuis J92408001N, me ofertë ekonomike 657.627.285.25 (gjashtëqind e pesëdhjete e shtate milion e gjashtëqind e njezet e shtatemije e dyqind e tetëdhjete e pese **pike** njezet e pese) Lek pa Tvsh.

- Operatori ekonomik “BAMI” shpk, me NUIS J94416206R, me ofertë ekonomike 662,716,888.30 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mije e tetëqind e tetëdhjete e tete **pike** tridhjetë) Lek pa Tvsh.

- Operatori Ekonomik “G.P.G. COMPANY” Shpk, me Nuis J64324443V, me oferte ekonomike 662,406,654.18 (gjashtëqind e gjashtëdhjete e dy milion e katërqind e gjashtë mije e gjashtëqind e pesëdhjete e katër **pike** tetëmbëdhjete) Lek pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1- Operatori ekonomik “BAMI” shpk, me NUIS J94416206R, me ofertë ekonomike 662,716,888.30 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë mije e tetëqind e tetëdhjete e tete **pike** tridhjetë) Lek pa Tvsh.

2- Operatori Ekonomik “G.P.G. COMPANY” Shpk, me Nuis J64324443V, me oferte ekonomike 662,406,654.18 (gjashtëqind e gjashtedhjetë e dy milion e katërqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër *pikë* tetëmbëdhjetë) Lek pa tvsh.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

I- Operatori Ekonomik “BAMI” shpk, me NUIS J94416206R.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Ne Kriteret e veçanta të kualifikimit shkronja ”F”,parashikohet se: Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë: *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE rezulton mungon deklarata mbi disponueshmërinë e mjeteve (shtojca 10). Ky kriter është vendosur nga autoritet perkatëse ne DST, te kriteret e vecanta (shtojcat), te cilat nuk mund te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospermbushja e ketyre kriterëve perben shkak per skualifikimin e ofertuesve.

Se dyti, nuk plotëson pikën 2.3.3, ne lidhje me disponimin e licenses profesionale te shoqërisë qe ushtrojnë aktivitet veprimtari ndërtuese zbatimi. OE nuk disponon licensen ne kategorite e kerkuara ne DST, per NP-12 F, NS-16 B dhe NS-20 C, pasi nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar OE disponon kategoritë NP-12 D, NS-16 D dhe NS-20 B, duke mos permushur kete kriter te kerkuar nga AK.

Se treti, ne piken 2.3.4, parashikohet se: Operatori/et ekonomike ofertues duhet të paraqesin dëshmi nga administrata tatimore ku të ketë një punësim mesatar i të paktën 195 (Njëqind e nëntëdhjetë e pese) punonjës për periudhën Qershor 2020 – Nentor 2020. Referuar listpagesave te ngarkuar ne SPE nga OE, rezulton se numri mesatar i punonjesve per periudhen Qershor – Nentor 2020 është 184.

Se katerti, ne piken 2.3.6/a, parashikohet se: Krahas stafit te mesiper Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin mbështetës të shoqërisë edhe: Minimumi **4 (katër) specialist** të pajisur me certifikatë trajnimi për ngjitjen e tubave HDPE e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Nga verifikimi rezulton se OE, nuk ka ngarkuar ne SPE asnje dokumentacion qe provon disponimin e ketyre punonjesve te certifikuar per ngjitjen e tubave HDPE.

Se pesti, ne piken 2.3.6/c, parashikohet se: Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij **1 (një) mjek** në bazë të paragrafit 12/2 të VKM Nr. 692, datë 13.12.2001 “Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë, i ndryshuar dhe të Ligjit Nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, VKM Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, (i ndryshuar).

Nga verifikimi rezulton se OE, nuk ka ngarkuar ne SPE asnje dokumentacion qe provon permbushjen e ketij kriteri.

Se gjashti, nuk ploteson piken 2.3.8/a ne lidhje me disponimin e certifikatave ISO sepse OE nuk ka ngarkuar ne SPE asnje dokumentacion mbi disponimin e certifikatave ISO: PAS 99-2012, ISO 50001-2011, EN ISO 3834-2 :2016, SSH EN 13331-1:2001.

Se shtati, nuk ploteson piken 2.3.9 sepse nuk eshte ngarkuar ne SPE asnje dokumentacion per materialet: tuba HDPE.

OE nuk ka ngarkuar ne SPE asnje kontrate furnizimi apo marreveshje bashkepunimi me prodhues te ketyre materialeve.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur ne nenin 46, pika 1 germa "b", te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;" si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit", vendosi te refuzoje oferten e **OE "BAMI" Shpk**, per mos permbushje te kriterave te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik". të ndryshuar, Operatori Ekonomik "BAMI" shpk, me NUIS J94416206R, skualifikohet.

II- Opertori Ekonomik "G.P.G. COMPANY" Shpk, me Nuis J64324443V.

Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se OE:

Se pari, OE nuk ka ngarkuar ne SPE asnje nga shtojcat e kerkuara ne DST, te kriteret e vecanta te kualifikimit, pervec ofertes ekonomike. Shtojcat janë kriteret e cilat nuk mund te ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Mospermbushja e ketyre kriterave perben shkak perskualifikimin e ofertuesve.

Se dyti, nuk ploteson kriterin 2.3.1 ne lidhje me pervojen e suksesshme ne realizimin e puneve te ngjashme. Nga verifikimi rezulton se OE ka ngarkuar ne SPE, nje pune te vetme te realizuar ne vleren 207,838,837 Leke, duke e bere te pa permbushur kete kriter pasi minimumi i kerkuar ne DST eshte prej 332,202,251 Leke.

Se treti, nuk ploteson piken 2.3.5/d, pasi OE nuk ka plotesuar deklaraten qe percakton drejtuesin teknik te punimeve ne objekt gjate gjithë afatit te punimeve.

Se katerti, nuk ploteson piken 2.3.9, pasi nuk eshte ngarkuar ne SPE asnje dokumentacion per materialet: tuba HDPE. OE nuk ka ngarkuar ne SPE asnje kontrate furnizimi apo marreveshje bashkepunimi me prodhues te ketyre materialeve. Gjithashtu OE nuk ka paraqitur dokumentacion

mbi katalogjet, raportet apo certifikata testimi, se tubat e mesiperm jane per perdorim per uje te pijshem.

Se pesti, nuk ploteson piken 2.3.12, pasi nuk eshte ngarkuar ne SPE vetedeklarimi qe brenda se njejtës periudhe nuk eshte kontraktor/nenkontraktor per kontrata te lidhura me vlere te perbashket ose te vecante , jo me te madhe se 100% te kufirit maksimal.

Sa me siper Komisioni i Vleresimit te Ofertave mbeshtetur në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asetë të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;” si dhe ne në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit” vendosi te refuzoje oferten e **Operatorit Ekonomik “G.P.G COMPANY” Shpk**, per mos permbushje te kriterëve te vecanta kualifikuese.

Si perfundim, në mbështetje të nenit 46, 53, 54 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. të ndryshuar, Operatori Ekonomik “G.P.G COMPANY” Shpk, me Nuis J64324443V, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë OE A. N. K. Shpk, me adrese “Rruga e Kavajes”, Pallatet “Condor”, Kulla 1, Hyrja e pare, kati i trete, Tirane, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 657.627.285.25 (gjashtëqind e pesëdhjete e shtate milion e gjashtëqind e njezet e shtatemije e dyqind e tetëdhjete e pese *pikë* njezet e pese) Lek pa Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Lezhe sigurimin e kontratës dhe dokumentat, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlere përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 19/01/2021

Ankesa: Nuk Ka

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

K R Y E T A R I

Pjerin NDREU